



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/11

Datë: 13.03.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2007, mori

V E N D I M

1. Miratohet, me vërejtje, ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së 10 të Qeverisë së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të Zyrës së Kryeministrit
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/11
Datë: 13.03.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2007, mori

V E N D I M

1. Shtetasve të Republikës së Kosovës iu lejohej nxjerrja e Dokumenteve Civile të Republikës së Kosovës: Letërnjoftimet, Dokumentet e Udhëtimit dhe Patentë-Shoferët, në harmoni me ligjet e Republikës së Kosovës.
2. Agjencioni i Prokurimit Publik i Kosovës t'i lejojë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës përdorimin e procedurës së negociuar, në harmoni me nenin 34.2. a (ii) të Ligjit mbi Prokurimin Publik të Kosovës, nr. 2003/17 për:
 - a) Furnizimin me libreza të papersonalizuara - dokumente të Udhëtimit të Republikës së Kosovës për shtetasit e Republikës së Kosovës, si dhe furnizimin me repromaterial (kartela) për patentë-shoferë të Republikës së Kosovës për shtetasit e Kosovës. Kompania me të cilën do të negociohet për këtë furnizim është kompania "Giesecke & Devrient" nga Gjermania.
 - b) Furnizimin me letër speciale (Teslina) dhe material plastifikues (rollne Print dhe rollne Clear) për shtypjen e letërnjoftimeve të Republikës së Kosovës për shtetasit e Republikës së Kosovës. Kompania me të cilën do të negociohet për këtë furnizim është kompania "Thales" nga Franca.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe Agjencioni i Prokurimit Publik të Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të Zyrës së Kryeministrit
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/11
Datë: 13.03.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2007, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Sigurinë Private.
2. Ngarkohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi t'ia procedojë për miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të Zyrës së Kryeministrit
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/11
Datë: 13.03.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2007, mori

V E N D I M

1. Miratohet, me ndryshime, Projektligji për Vulat në Institucionet e Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Zyra për Shërbimet e Ndhmës Juridike e Zyrës së Kryeministrit për inkorporimin e vërejtjeve.
3. Ngarkohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi t'ia procedojë për miratim Kuvendit të Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të Zyrës së Kryeministrit
- Arkivit të Qeverisë